



UNIVERSITÀ CATTOLICA
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO

Nr. Prot. 21

Tiranë, 23/01/2026

UNIVERSITETI KATOLIK “ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

DOKTORATË

NDËRKOMBËTARE NË PROGRAM TË PËRBASHKËT STUDIMI
ME DEPARTAMENTIN E ARKITEKTURËS TË UNIVERSITETIT TË FIRENCES
ME QËLLIM LËSHIMIN E NJË DIPLOMË TË DYFISHTË

në:

**“ARKITEKTURA MESDHETARE:
PROJEKTI, NJOHJA DHE RUAJTJA E TRASHËGIMISË KULTURORE”**

THIRRJE PËR KONKURS

Botimi I, Viti Akademik 2025-2026

Tiranë, Shqipëri



Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” (në vijim UKZKM), në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktivizon për vitin akademik 2025-2026, programin e Doktoratës në: **“Arkitektura Mesdhetare: Projekti, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore”**, një program arsimor ndërkombëtar i përbashkët me Universitetin e Firences (Departamenti i Arkitekturës), i cili u mundëson doktorantëve, përmes mobilitetit dhe mbikëqyrjes së përbashkët, të zhvillojnë aktivitetin kërkimor në periudha të alternuara në të dy institucionet dhe të marrin në përfundim të ciklit të studimeve dhe me një mbrojtje të vetme të tezës, **diplomën e dyfishtë “Doktor”**. Numri i kuotave të rezervuara për programin e studimit është 6: nga të cilat 5 prej tyre janë të rezervuara për shtetas shqiptarë, ndërsa 1 është rezervuar për shtetas të huaj.

Neni.1. Objektivat Formuese

Ky program doktorate ofron kompetencat e nevojshme për të ushtruar veprimtari kërkimore me kualifikim të lartë, në mënyrë të pavarur, pranë institucioneve publike dhe private.

Doktorata synon t’u ofrojë kandidatëve një bazë të fortë në metodologjitë e kërkimit shkencor, duke përfshirë aftësitë e analizës kritike, përdorimin e instrumenteve të avancuara të kërkimit shkencor, si dhe zhvillimin e njohurive të reja në fushën e arkitekturës mesdhetare dhe të ruajtjes së saj.

Kandidatët inkurajohen të eksplorojnë në mënyrë të thelluar teoritë arkitekturore, urbanistike dhe të dizajnit, duke kontribuar në zhvillimin e mendimit kritik dhe në kuptimin e dinamikave historike, kulturore dhe shoqërore që ndikojnë në këtë fushë të arkitekturës.

Përveç formimit akademik, doktorantët marrin formim edhe në kompetenca trasversale, të tilla si menaxhimi i projekteve, komunikimi shkencor dhe veprimtaria didaktike, me qëllim përgatitjen e tyre për një karrierë si në fushën akademike ashtu edhe në atë profesionale.

Doktorantët inkurajohen të kontribuojnë në mënyrë aktive në debatin akademik dhe profesional, përmes publikimit të artikujve shkencorë, pjesëmarrjes në konferenca dhe ndërveprimit me kërkues shkencor të tjerë.

Këto objektiva synojnë të formojnë arkitektë-kërkues shkencor, të aftë për të kontribuar në mënyrë të ndjeshme në avancimin e disiplinës dhe për t’u përballur me sfidat bashkëkohore të ruajtjes së trashëgimisë së ndërtuar.

Neni.2. Kohëzgjatja e Programit dhe Programi Arsimor

Doktorata në “Arkitektura Mesdhetare: Projekti, Njohja dhe Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore” zhvillohet në mënyrë të përbashkët me Departamentin e Arkitekturës të Universitetit të Firences.

Kohëzgjatja e programit të doktoratës është 3 vite akademike, që për Italinë korrespondon me një cikël studimi, dhe 3–5 vite akademike për Shqipërinë. Zgjatja e afatit të studimeve kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Doktoratës.



Programi i studimit të Doktoratës zhvillohet me kohë të plotë pranë Njesisë bazë ose me kohë më të zgjatur, në rastet kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë ose si personel kërkimor në një institucion kërkimor bazë apo të aplikuar.

Në kuadër të programit arsimor parashikohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të lartpërmendura.

Gjatë programit të doktoratës, zakonisht brenda vitit të parë të studimeve, doktoranti/ja lidh një Marrëveshje Individuale (Shtojca 1). Universiteti i origjinës përcaktohet si institucion i regjistrimit të parë, ndërsa Universiteti drejt të cilit realizohet mobiliteti përcaktohet si institucion i regjistrimit të dytë ose Universiteti pritës. Periudha e studimit që kërkohet pranë Universitetit pritës nuk mund të jetë më pak se 12 muaj (dhe as në mënyrë jo të vazhdueshme).

Temat specifike të kërkimit shkencor do të zhvillohen nga secili kandidat nën udhëheqjen e udhëheqësve dhe bashkë-udhëheqësve italianë dhe shqiptarë. Çdo doktorant do të ndiqet nga një udhëheqës, i cili do të ndjekë dhe orientojë veprimtarinë e tij kërkimore. Në përfundim të programit, kandidati do të përpunojë të dhënat e kërkimit në lidhje me temën e vet specifike, për përgatitjen e disertacionit dhe paraqitjen përfundimtare të projektit.

Gjatë periudhës trevjeçare, doktoranti/ja duhet të marrë 30 kredite formuese, nga të cilat të paktën 6 për kurse të avancuara që lidhen me të ashtuquajturat “kompetenca trasversale”, përmes ndjekjes së kurseve të parashikuara nga programi i doktoratës si dhe pjesëmarrjes në konferenca, seminare dhe takime, në përputhje me ofertën arsimore të dy Universiteteve. Në rast se një pjesë e krediteve fitohet pranë Universitetit pritës, ato duhet të njihen dhe të validohen nga Universiteti i regjistrimit të parë.

Kualifikimi akademik “Doktor” fitohet me përfundimin dhe mbrojtjen e tezës, në përmbyllje të studimeve të doktoratës në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Secili Universiteti lëshon një diplomë që vërteton dhënien e titullit Doktor, të cilat lëshohen në përputhje me rregulloret e veta, me shënimin përkatës të Universitetit tjetër në cilësinë e universitetit partner në një doktoratë të përbashkët të tezës.

Neni.3. Kriteret e Pranimi

Mund të paraqesin kërkesë për pjesëmarrje në konkursin e pranimi të këtij programi Doktorate kandidatët që zotërojnë një Diplomë Master Shkencor të Integruar ose një program të integruar studimi të ciklit të dytë Master Shkencor të përfutur pranë UKZKM, Universiteteve publike ose private shqiptare të akredituara institucionalisht, ose pranë çdo Universiteti tjetër të njohur nga autoritetet përkatëse të vendit të origjinës.

Diplomat e përfutura jashtë vendit duhet të shoqërohen me dokumentin e Njohjes/Njehsimi të tyre, të lëshuar nga Ministria e Arsimit në Republikën e Shqipërisë ose nga institucionet e



ngarkuara përkatëse.

Diploma e Masterit Shkencor që kandidati zotëron duhet t'i përkasë njërës prej fushave/programëve të mëposhtme të studimit:

- Arkitekturë
- Inxhinieri
- Histori
- Arkeologji

Kandidati duhet të zotërojë dhe të ketë dëshmi për njohjen e njërës prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht. Në rast se kandidati zotëron një diplomë të një programi studimi të zhvilluar në njërën nga pesë gjuhët e lartpërmendura, kjo diplomë shërben si dëshmi e njohjes së gjuhës përkatëse. Certifikimi i gjuhës së huaj duhet të jetë në përputhje me Urdhrin nr. 52, datë 03.12.2015, të Ministrisë së Arsimit shqiptare, dhe niveli minimal i kërkuar i njohjes së gjuhës duhet të jetë C1.

Në konkurs pranohen kandidatët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- që kanë një notë përfundimtare të diplomës Master Shkencor të barabartë ose më të lartë se **96/110** (për të diplomuarit në sistemin universitar italian);
- që kanë një mesatare aritmetike të provimeve të dhëna gjatë studimeve universitare, përfshirë edhe provimin përfundimtar, të barabartë ose më të lartë se **8/10** (për të diplomuarit në sistemin universitar shqiptar).

Neni.4. Mënyrat e Pranimit

Kërkesa për pjesëmarrje në përzgjedhjen për programin e Doktoratës, së bashku me dokumentacionin shoqërues të parashikuar nga kjo thirrje konkursi, duhet të dorëzohet në format fizik (letër) brenda orës **15:00, datë 27.02.2026**, pranë Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, UKZKM, në të kundërt kandidati përjashtohet nga procedura e përzgjedhjes. Kërkohet gjithashtu dorëzimi i një kopjeje digjitale të dosjes, e cila duhet të dërgohet brenda të njëjtit afat në adresën elektronike: segreteria.architettura@unizkm.al.

Kërkesa për pranimin në programin e doktoratës duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a. Kërkesë e kandidatit, drejtuar Dekanit të Fakultetit, e depozituar pranë sekretarisë së Njesisë bazë që ofron programin e studimit.
- b. Curriculum Vitae (CV) e kandidatit, që përfshin arsimin e lartë, kualifikimet përkatëse dhe përshkrimin e karrierës së mëparshme universitare ose të veprimtarive të tjera akademiko-shkencore.
- c. Kopje e noterizuar e diplomës "Master Shkencor", e diplomës së përfutur në përfundim të sistemit të vjetër katërvjeçar, të programeve të integruara të ciklit të dytë (DIND), ose e çdo diplome tjetër të barasvlershme me to, e pajisur me listën e notave ose me suplementin e diplomës. Diploma e përfutur jashtë vendit duhet të shoqërohet me vërtetimin e njehsimit, të lëshuar nga Ministria e Arsimit. Diplomat e përfutura në



Universitetet e huaja duhet të deklarohen të barasvlershme nga Ministria e Arsimit. Diplomës së përfituar jashtë vendit duhet t'i bashkëngjitet dokumenti i Njehsimit, i lëshuar nga Ministria e Arsimit shqiptare. Në mungesë të këtij dokumenti, kandidati regjistrohet me kusht, duke pasur gjithsesi detyrimin për ta paraqitur atë para fillimit të veprimtarive mësimore dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e publikimit të rezultateve të renditjes përfundimtare.

- d. Kopje e noterizuar e diplomave ose certifikatave të kualifikimeve të tjera, nëse kandidati disponon të tilla.
- e. Kërkesë për fushën specifike kërkimore, që lidhet me programin përkatës të doktoratës.
- f. Propozim kërkimi shkencor i kandidatit. Propozimi i kërkimit shkencor duhet të përgatitet në formën e një projekti kërkimor, në fushën e studimit që lidhet me programin e doktoratës;
- g. Kopje e noterizuar e kartës së identitetit ose e pasaportës.
- h. Dy fotografi në format pasaporte.
- i. Dy (2) rekomandime nga profesorë të njohur të fushës përkatëse të studimit, me kualifikime akademike.
- j. Certifikata ndërkombëtare të njohjes së njërës prej pesë gjuhëve të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht. Në rast se kandidati zotëron një diplomë të një programi studimi të zhvilluar në njërën nga pesë gjuhët e lartpërmendura, kjo diplomë shërben si certifikatë.
- k. Certifikatë e lëshuar nga zyra e punësimit ose Vërtetim punësimi, i lëshuar nga punëdhënësi, për kandidatët që janë të punësuar pranë institucioneve të tjera.
- l. Mandat pagese i tarifës së regjistrimit në vlerën 2000 ALL.
- m. Kopje e publikimeve, nëse ka;
- n. Kopje e dokumenteve që vërtetojnë pjesëmarrjen në projekte kërkimore ose veprimtari të tjera kërkimore;
- o. Deklaratë e kandidatit se nuk është i regjistruar njëkohësisht në asnjë program tjetër studimi universitar, në Republikën e Shqipërisë apo jashtë saj.

Dosja individuale e kandidatit paraqitet pranë sekretarisë së njësisë bazë të programit të studimit.

Në rast se Dosja e Kandidatit nuk është e plotë, për shkak të mungesës së dokumentacionit të lartpërmendur, kërkesa për pranimin në doktoraturë nuk do të merret në shqyrtim. Kërkesat e dorëzuara pas përfundimit të afatit të përcaktuar nuk do të pranohen.

Neni.5. Mënyrat e Përzgjedhjes

Pas paraqitjes së kërkesës për pranim (Dosja e Kandidatit), kandidatët do t'i nënshtrohen një faze të parë përzgjedhjeje, e cila konsiston në vlerësimin e titujve, përfshirë: karrierën akademike të kandidatit, veprimtarinë kërkimore shkencore, aktivitetin akademik, publikimet



dhe CV -së (curriculum).

Faza e dytë e përzgjedhjes konsiston në një intervistë, gjatë së cilës kandidati do të paraqesë projektin e tij kërkimor, duke demonstruar zotërimin e njohurive bazë të mendimit krijues dhe kritik. Në intervistë do të pranohen vetëm kandidatët që do të rezultojnë të kualifikuar në vlerësimin e titujve.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet mbi një total prej 100 pikësh, të ndarë si më poshtë:

A. Vlerësimi i Dosjes së Kandidatit (Maksimumi 80 pikë)

Vlerësimi i Dosjes do të kryhet bazuar në zërat e mëposhtëm:

Diploma	_____	max.25 p
Formim post-Diplomim	_____	max.15 p
Pjesëmarrja në projekte kërkimore dhe aktivitete të tjera kërkimore	_____	max.15 p
Publikime shkencore	_____	max.15 p
Eksperienca pune dhe kurse kualifikimi lidhur me Doktoraturën	_____	max.10 p

Në përfundim të procedurës së pranimit, Komisioni do të publikojë renditjen përfundimtare të kandidatëve bazuar në pikët e fituara nga secili kandidat. Renditja zyrtare do të publikohet në ambientet e UKZKM jo më vonë se data **06.03.2026**.

B. Provimi me gojë (Maksimumi 20 pikë)

Provimi me gojë ka për qëllim të verifikojë aftësinë e kandidatit për kërkimin shkencor dhe përgatitjen e përgjithshme. Kandidati duhet të paraqesë para Komisionit propozimin e tij/saj individual kërkimor.

Provimi me gojë do të zhvillohet më datë **11.03.2026, ora 09:00**, në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Rr. Dritan Hoxha, Kompleksi Spitalor Universitar 'Zoja e Këshillit të Mirë'. Pas përfundimit të intervistës, përgjegjësi i programit të studimit, së bashku me 2 (dy) anëtarë të personelit akademik të njësisë bazë, do të përgatisin renditjen përfundimtare me vlerësimin e kandidatëve.

Neni.6. Regjistrimi në programin e Doktoratës

Regjistrimi i kandidatëve do të kryhet sipas modaliteteve dhe afateve të përcaktuara nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në momentin e publikimit të renditjes përfundimtare.

Rektori

Prof. Leonardo Palombi